



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 27.12.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:20 dhe mbaroi në orën 12:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Erion Fejzulla, USAID.*
7. *Julinda Beqiraj, EURALIUS..*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e fondeve buxhetore, shpenzimeve korente, në sistemin gjyqësor për vitin 2020”.

Naureda Llagami: Përshëndetje, siç jeni njoftuar, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 27.12.2019. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët, përveç zonjës Ukperaj e cila është me leje të zakonshme.

Siç kemi parashikuar në rendin e ditës, sot do marrim në shqyrtim projektvendimin “Për detajimin e fondeve buxhetore, shpenzimeve korente, në sistemin gjyqësor për vitin 2020”, projekt-akti i cili do të relatohet prej meje (nga Komisioni) dhe është përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Administrimit të Buxhetit.

Atëherë, buxheti i shtetit për vitin 2020 është miratuar me ligjin nr.88/2019, pjesë e të cilit është edhe buxheti për Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili është i ndarë në dy programe. Programi i parë është “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi KLGJ-së” dhe programi i dytë është “Buxheti gjyqësor”. Bazuar në këtë buxhet, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka përgatitur detajimin e tij në nivel njësie shpenzuese. Për vitin 2020 buxheti është 3,409,150 mijë lekë, ndërkohë, krahasuar me kërkesën tonë në projektbuxhet është rreth 450,000 mijë lekë më i ulët. Numri i punonjësve shtesë të kërkuar ishte 157, ndërsa është miratuar 100 punonjës.

Detajimi i fondeve buxhetore korente për programin “Planifikim, Menaxhim dhe

Administrim” – buxheti i miratuar në këtë program në shpenzimet korente, shpenzime personeli dhe ato operative, është i njëjtë me kërkesat buxhetore.

Shpenzime personeli që përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore.

Buxheti për shpenzime personeli është në shumën 215,000 mijë lekë, i ndarë përkatësisht në 180,000 mijë lekë në paga dhe 27,000 mijë lekë në sigurime shoqërore. Ky fond është përllogaritur për 125 punonjës që punojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Shpenzimet operative – buxheti i miratuar në shpenzime operative është në vlerën 60,150 mijë lekë.

Shpenzime kapitale – bëhet fjalë buxheti i miratuar në shpenzime kapitale është në vlerën 49,600 mijë lekë.

Për të mundësuar funksionimin normal të KLGJ-së për vitin 2020 i është kërkuar Ministrisë së Financave një shtesë fondi në shpenzime kapitale, një fond në vlerën 27,700 mijë lekë për fillimin e aktivitetit të KLGJ-së në godinën e re, për instalimin e sistemit të regjistrimit audio dhe video për mbledhjet plenare në plotësim të detyrimeve ligjore, gjenerator për energji të pandërprerë për godinën, etj., të cilat nuk do të plotësoheshin më nga AKSHI siç ishte njoftuar në fillim. Për fillimin e projektit për sistemin e ri elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, pjesë e objektivave të planit strategjik të KLGJ-së. Nga vlerësimet e ekspertëve të EURALIUS, ky sistem vlerësohet të kushtojë rreth 3.5 milion euro (e thënë në lekë është 440,000 mijë lekë). Për vitin e parë u kërkua një fond rreth 100,000 mijë lekë. Fondi i akorduar në investime për KLGJ-në është 49,600 mijë lekë. Ky fond është ulur krahasuar me shifrat e projektuara si në fazën e parë ashtu edhe në fazën e dytë, të negociimit të buxhetit. Me këtë fond të akorduar, do të jetë e vështirë për të plotësuar nevojat në investime sikurse janë nevojat për kompjuterë, gjenerator, sistemi audio-video i sallës së mbledhjeve të Këshillit, në godinën e re. Fondi i investimeve do të detajohet në një fazë të dytë, pasi të kemi qartësuar pagesat që do të kryhen deri në fund të vitit nga Dega e Thesarit Tiranë.

Detajimi i fondeve buxhetore korente për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” – Shkurtimisht, buxheti i miratuar për shpenzime personeli është 2,489,000 mijë lekë, i ndarë në 2,244,000 mijë lekë në paga dhe 245,000 mijë lekë në sigurime shoqërore. Numri i miratuar i punonjësve është 1,468 punonjës dhe ka një rritje me 100 punonjës, krahasuar me vitin 2019.

Fondi i akorduar në shpenzime personeli është 192,000 mijë lekë më pak, se sa fondi i kërkuar.

Nga ana tjetër është e qartë situata e mungesës së numrit të punonjësve në sistemin gjyqësor. Numri faktik i tyre në dhjetor 2019 është 1,216 punonjës, kundrejt 1,368 punonjës në strukturë organike, me një diferencë prej 152 punonjës. Nga 152 mungesa në strukturat organike, 73 janë magistratë dhe 79 janë administratë gjyqësore.

Aktualisht 19 magistratë janë të shkarkuar nga KPA-ja me vendim të formës së prerë, 19 magistratë janë të dorëhequr dhe 21 vende vakante magistratë të paplotësuara më parë. Pra gjithsej 59 vende janë vakante.

Për sa i përket mungesave në administratën gjyqësore, pjesa më e madhe e tyre është në Gjykatën e Lartë, mungojnë 54 punonjës të administratës gjyqësore të kësaj gjykate.

Gjithashtu ka mungesa në strukturat organike të gjykatave të apelit dhe shkallës së parë, gjithsej 25 punonjës të administratës gjyqësore.

Gjatë vitit 2020, planifikohen të futen në sistem 15 magistratët që kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës në vitin 2019 dhe 10 të tjerë që priten të emërohen mbas mbarimit të shkollës në muajin qershor 2020.

Për çdo gjykatë, është detajuar buxheti në paga dhe sigurime shoqërore bazuar në numrin faktik të magistratëve. Fondi i nevojshëm i përlogaritur për të gjitha gjykatat është në vlerën 2,293,250 mijë lekë përkatësisht: 2,078,900 mijë lekë në paga dhe 214,350 mijë lekë në sigurime shoqërore. Ky fond kalohet në çdo gjykatë.

Është përlogaritur fondi vjetor në shpenzime personeli për 100 punonjësit shtesë të miratuar në vlerën 115,000 mijë lekë: përkatësisht 102,000 mijë në paga dhe 12,000 mijë në sigurime shoqërore.

Është kërkuar nga Ministria e Financave miratimi për 71 punonjës me kontratë të përkohshme pune. Fondi i nevojshëm për punonjësit me kontratë, në rast miratimi, është i përlogaritur në vlerën 49,000 mijë lekë, përkatësisht 42,000 mijë në paga dhe 7,000 mijë në sigurime shoqërore dhe është për 12 muaj. Përlogaritja e fondeve është bazuar në planifikimin që Drejtoria e Burimeve Njerëzore të KLGJ-së ka bërë për shpërndarjen e tyre.

Buxheti i përlogaritur për punonjësit shtesë dhe ata me kontratë deri në detajimin e tyre do të mbahet i pashpërndarë në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në artikullin

“Paga” dhe “Sigurime shoqërore”.

Me detajimin e numrit shtesë 100 punonjës dhe miratimin e numrit të punonjësve me kontratë do të kryhen edhe rialokimet përkatëse me miratimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me shpenzimet operative më lejoni t’ju informoj që këto shpenzime kanë të bëjnë me aktivitetet e përditshme të gjykatave, këtu përfshihen shpenzime kancelarie, shpenzime energjie elektrike, shpenzime uji, shpenzime mirëmbajtje godine, pajisje elektronike, shpenzime poste, shpenzime për ekspertë, avokatë kryesisht, etj. Gjithashtu përfshihen edhe shpenzime të tjera specifike të cilat kryhen nga gjykatat jo çdo vit por sipas rrethanave të krijuara. Të tilla janë shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, shpenzime për kolegjin zgjedhor, etj.

Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2020 është 437 mijë lekë, ndërsa kërkesa buxhetore në këto shpenzime, ishte 454 mijë lekë. Në këtë kërkesë ishte përfshirë edhe buxheti 25,000 lekë për mirëmbajtjen e sistemit ICMIS, shërbim i cili ka kaluar nga Ministria e Drejtësisë, në përgjegjësi të KLGJ-së.

Para llogaritjes së fondeve për çdo gjykatë janë marrë në konsideratë disa shpenzime të cilat do të kryhen për të gjitha gjykatat të cilat do të mbahen të grupuara brenda të njëjtit program.

Këto shpenzime që do të mbahen të grupuara janë si më poshtë:

Kështu, fillojmë me: Mirëmbajtjen e sistemit ICMIS për gjykatat, në vlerën 25,000 lekë; Mirëmbajtjen e sistemit audio për gjykatat, në vlerën 6,200 lekë; Mirëmbajtjen e programit Alpha web për gjykatat, në vlerën 6,200 lekë; Ruajtja e godinave të gjykatave në vlerën 75,800 mijë lekë në përputhje me VKM nr. 177/2019 “Për krijimin e shoqërisë Ilyrian Guard sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”.

Për vitin 2020, gjykatat kanë parashikuar të kenë në dispozicion nga të ardhurat një buxhet rreth 49 mijë lekë, nga të cilat 34 mijë lekë në shpenzime operative dhe 15 mijë lekë në investime. Ky buxhet do të përdoret për plotësimin e një pjese të nevojave në shpenzime operative dhe investime, sipas një ndarje të parashikuar.

Pra kjo ishte një prezantim i shkurtër dhe detajim i buxhetit i cili është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Nëse doni ndonjë sqarim më të detajuar lidhur me informacionin që ju dhashë,

pranë nesh është edhe zona Laze e cila mund t'ju japi edhe më shumë sqarime se sa Komisioni. Faleminderit!

Luljeta Laze: Do doja të thoja nja dy sqarime të vogla, për të përshkruar procesin se si ne kemi detajuar këtë buxhet.

Së pari, dua të sjell në vëmendje këtu që pagat për shpenzime, fondi për shpenzime personeli është goxha më i ulët se sa ai i kërkuar. Sigurisht, ka një raport të caktuar që neve kërkesën tonë e bëjmë bazuar në strukturat e plota organike që kemi, ndërsa fondi i akorduar është shumë më i ulët dhe këtu, në detajimin e këtij buxheti jemi mbështetur fort për ta menaxhuar sa më mirë atë, duke iu referuar numrit faktik që kemi sot. Dihet që ka shumë mungesa në sistemin gjyqësor dhe kryesisht janë ato për magjistratë, të cilat janë të shpjeguara këtu të detajuara.

Por ajo që unë do thoja është kjo që, neve, çdo gjykatë ne i kemi detajuar fondet për shpenzimin e pagave sipas numrit faktik që ajo ka dhe nga ana tjetër kemi mbajtur, janë përlllogaritur cilat janë fondet që duhen dhe i kemi mbajtur të pashpërndara për punonjësit shtesë që na janë akorduar dhe për punonjësit e kontratë që mendohet që do na akordohen, shpresojmë që do akordohen sepse ato, vit për vit, pasi është bërë kërkesa, nuk na i kanë ndryshuar dhe, gjithashtu është mbajtur edhe fondi që do të duhej nëse do të emëroheshin magjistratët (15 që mund të emërohen që tani edhe 10 të tjerë pas mbarimit të Shkollës së Magjistraturës, për gjashtëmujorin pra bëhet fjalë). Këto fonde janë përlllogaritur dhe janë mbajtur të pashpërndara, edhe për faktin se ne nuk e dimë se ku do shpërndahen këto punonjës, pas vendimeve që do marri Këshilli për t'i shpërndarë, edhe për të patur një menaxhim sa më të mirë të buxhetit. Në të gjitha rastet që do ketë emërim nga ana juaj, këto do shoqërohen edhe me alokomin përkatës të fondeve që në këtë moment është i pashpërndarë. Menduam që kjo do ishte një mënyrë e mirë për ta menaxhuar buxhetin e pagave, i cili është goxha me ulje, referuar asaj që ne kemi kërkuar. Kjo për sa i përket fondit të pagave.

Doja të nënvizoja këtu që pagat për Këshillin e Lartë Gjyqësor janë të plota. Buxheti gjyqësor e kishte këtë mangësi kaq të madhe.

Në qoftë se ka ndonjë pyetje për këtë.

Brunilda Kadi: Një pyetje.

Kur ju thoni që keni marrë parasysh numrin faktik, Luli, çfarë keni parasysh, domethënë, të gjyqtarëve? Ta zëmë, një gjykatë x, në qoftë se ka të shkarkuar, por që janë

të pezulluar. Kjo.

Tjetra. Kur thoni faktik, ta zëmë që është një gjykatë që është e plotë dhe ka vende vakante, vende vakante të përhershme për gjyqtar, këtu si është llogaritur? Domethënë, pritshmëria që të zihen këto vende gjatë vitit 2020 të plotësohen nga magjistratët e rinj.

T'i bëj një e nga një se kam edhe nja dy gjëra të tjera.

Luljeta Laze: Atëherë, në qoftë se... tek materiali do ta shikoni që ne i kemi shumë të detajuara: sa është numri i magjistratëve që tashmë kanë dalë edhe pas vendimit të KPA-së dhe, sa është i atyre që kanë vetëm vendimin e parë nga KPK-ja, që janë të pezulluar. Për këta që janë të pezulluar, sigurisht që e kemi lënë fondin sepse ata paguhen me 75%. Për ata që janë nga KPA-ja, e kemi konsideruar që nuk janë.

Gjithashtu ne kemi të trashëguara edhe më përpara sepse para se të krijohet KLGJ-ja kishte disa vende (rreth... nuk më kujtohet tani numri, rreth 30 besoj, 37) vakante për magjistratë, të cilat nuk ishin për shkak të, që nuk bëheshin më në atë kohë emërimi, ishin të lira. Kështu që edhe këto i kemi konsideruar që nuk janë. Pra në mënyrë shumë të detajuar, për secilën nga gjykatat kemi sa është numri në organikë i gjyqtarëve dhe sa është numri faktik i tyre, i specifikuar sipas këtyre të dyjave që thashë. Do të thotë që nuk janë fare, që është vendi vakant, apo që është i pezulluar dhe patjetër që atyre u kemi lënë fondin 75%.

Kurse për sa i përket mënyrës se si do të plotësohen, ne mendojmë që tani për tani, kështu e kemi menduar, e vetmja mënyrë është kjo e magjistratëve dhe fondin, unë e shpjegova që e kemi llogaritur sa është fondi për magjistratët, për 15 që tashmë e kanë mbaruar dhe sa do jetë për 6-mujorin tjetër për 10 magjistratë të tjerë që përfundojnë në qershor. Këtë fond e kemi lënë të pashpërndarë sepse ne nuk e dimë ku do shkojnë ata dhe në momentin që ju do merrni vendimet për shpërndarjen e tyre, këtë do ta shoqërojmë me fondet përkatëse, për periudhën që ata do jenë dhe për numrin që do caktohen për secilën gjykatë. Kjo është.

(Zonja Kadi i drejton një pyetje znj. Laze pa ndezur mikrofonin.)

Luljeta Laze: Atëherë, kjo është pjesë e shpenzimeve operative, në kuptimin e shpenzimeve që ata marrin. Kurse për pagat është pjesë... në qoftë se... Po, është pjesë e shpenzimeve.

Brunilda Kadi: Një pyetje që kam unë që nuk e kuptoj tek tabela është: "KLGJ-ja

punonjës shtesë 100 dhe pastaj 71 punonjës kontrate”, - çfarë është kjo? Janë për gjykata këto apo për vetë Këshillin.

Luljeta Laze: Atëherë, kërkesa... Ne kemi një plan të mirë detajuar bazuar tek kërkesat që ka pasur kuadri ligjor se sa punonjës shtesë do duheshin për të gjithë sistemin (për administratë gjyqësore e kam fjalën gjithmonë), për të plotësuar të gjitha detyrimet që duhen dhe kjo na ka rezultuar që është rreth 320 punonjës. Po! - shtesë.

Sigurisht që kërkesat për punonjës shtesë është e logjikshme që të mos bëhen të gjitha menjëherë por të jenë në mënyrë të strukturuar me faza sepse realisht kështu ndodh që edhe vetë plotësimi i tyre .. dhe është e lidhur me disa faktorë të tjerë, me krijimin e hartës së re gjyqësore, pra ndikojnë disa faktorë të tjerë, kështu që neve për vitin 2020 kërkuam 157 punonjës shtesë për administratën gjyqësore, gjysmën e atyre që mendojmë ne që do duheshin në mënyrë shumë teorike, dhe nga këto janë miratuar 100 punonjës shtesë. Ky është vërtetë një sukses, pavarësisht që nuk na i kanë dhënë të gjithë buxhetin sepse edhe Ministria e Financave shikon pjesën e menaxhimit të buxhetit sepse ajo e dinte. Këto 100 do të jenë në dorën tuaj për të përmirësuar të gjithë situatën e shërbimeve gjyqësore.

Ne kemi disa drejtime, sigurisht që ato bëhen me burimet njerëzore, por kemi disa drejtime që vërtetë në kemi nevojë për administratë gjyqësore. Po e filloj nga ajo nevoja e parë, -akoma është e paplotësuar nevoja shumë e ngutshme për sekretare gjyqësore. Ka gjykata që jo çdo gjyqtar, sidomos apelet e kanë një sekretare gjyqësore në krah për të përmbushur detyrimet e tyre. Por jo vetëm kaq, është projektvendimi që ne kemi parë për sigurinë e gjykatave dhe propozimi i fundit aty është që minimalisht një gjykatë duhet ta ketë një punonjës sigurie. Por jo vetëm kaq. Ka nevojë për ftues edhe nuk banalizohet fare problemi kur themi që ka nevojë edhe për ato punonjëset e shërbimit dhe të pastrimit. Që gjykatat të ofrojnë një shërbim dinjitoz për qytetarët, duhet nga A-ja deri tek Zh-ja, pra nga sekretaret gjyqësore deri tek punonjësja e pastrimit. Kështu që ju do e keni në dorë atë dhe do ta ndani këtë 100-ën.

Në momentin që do ndani 100 punonjësit unë thashë që e kemi përlllogaritur sa është nevoja për këta, e kemi përlllogaritur me pagën që mendojmë ne, është më e larta në sistem, që bëhet fjalë për sekretaret gjyqësore. Sepse ky është buxhet, zbatimi është që vjen fiks. Kjo është për të qenë brenda. Dhe ky buxhet pastaj që ne e kemi lënë rezervë aty, në momentin që ju do ndani punonjësit, se ashtu siç do shkojnë në çdo gjykatë, pra

kur të realizohet ndryshimi i strukturave, do t'iu shkojë edhe buxheti përkatës.

Atëherë, përveç punonjësve shtesë, në çdo vit, edhe ne kemi kërkuar, edhe me eksperiencën që kam gjetur këtu tek KLD-ja, kanë kërkuar punonjës me kontratë të përkohshme pune që quhen, të cilët punojnë ose 4 orë në ditë ose i merr 8 orë për 6 muaj. Këto janë disa nevoja që ti nuk i plotëson dot sepse nuk të japin të gjithë kërkesën që ke pasur për punonjës shtesë. Nëpërmjet këtyre lehtësohet procesi.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Po! Për gjykatat.

Kemi edhe për KLGJ-në besoj nja 8 punonjës sepse edhe ish-KLD-ja edhe KLGJ-ja ka pasur disa nevoja, sidomos në plotësimin e kërkesave që kanë pasur gjyqtarët për procesin e vetingut, janë hapur arkivat, pra ka pasur një punë intensive si këtu edhe në gjykata për këto procese, dhe janë shpërndarë punonjës sipas kësaj nevoje kryesisht. Sigurisht fondi që do duhet për këto është më i vogël sepse ata e kanë të reduktuar kohën edhe por edhe kjo gjë është marrë në konsideratë, por këto punonjës tashmë nuk janë shpërndarë akoma. Në momentin që do shpërndahen, edhe për këtë kemi bërë të njëjtën përllogaritje dhe fondet nuk i kemi shpërndarë në gjykata. Do të jetë rast pas rasti sipas vendimeve që ju do të merrni.

Brunilda Kadi: Po me qendrën e informacionit, Qendrën e Teknologjisë së Informacionit që ne kemi detyrim për ta ngritur, është parashikuar ndonjë?

Luljeta Laze: Ju shpjegoj.

Kemi çuar, në kërkesat tona buxhetore, që kemi bërë në Ministrinë e Financave, në mënyrë të detajuar, sa është nevoja për krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit. Kjo ka qenë/përllogaritet në bashkëpunim me Projektin EURALIUS, por ato fonde nuk janë akorduar në këtë moment dhe kjo është e logjikshme. Zakonisht, kur bëhet vendimi i qeverisë për krijimin e qendrës, shoqërohet edhe me buxhetet përkatëse që do duhet për këtë qendër.

Ajo që unë doja të theksoja pak këtu përtej qendrës është edhe fondet për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, të cilën unë jua kam detajuar aty. Në fakt ne në 2020-ën nuk kemi ndarë asnjë fond që të kemi çuar në Gjykatën e Lartë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Këtë do t'jua shpjegoj pse. Sepse neve kemi pretenduar që ky fond të jepet në mënyrë të veçantë Këshillit dhe kjo t'i kalohet drejtpërdrejtë Gjykatës së Lartë, ashtu sikurse u bë edhe në vitin 2019. Tani, në kushtet kur neve edhe buxhetet tona

i kemi shumë të kufizuara, mendoj që t'ia sjell edhe një herë në vëmendje Ministrisë së Financave që shiko, juve nuk na keni sjellë të veçantë fondin për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, na e sillni të veçantë. Neve jua kemi kërkuar të veçantë. Dhe në fakt, deri në këtë moment nuk kemi përcjellë ndonjë fond për këtë gjë.

Për teknologjinë e informacionit, ju thashë, kur del vendimi i qeverisë për krijimin e qendrës, do të shoqërohet me fondin përkatës.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Luljeta, unë kisha një pyetje në lidhje me fondet e akorduara për sa i përket mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit të çështjeve nëpër gjykata.

Nga sa shikoj këtu, rezulton që na janë akorduar 17 milion lekë më pak se sa është kërkuar. Pra nga 454 milion lekë, janë akorduar 437 milion lekë? Është e saktë kjo?

Luljeta Laze: Atëherë, që ta fillojmë, kjo i përket fondit në shpenzime operative. Në fakt, fondi në shpenzime operative është shumë më i ulët se ajo që ne kemi kërkuar. Në mënyrë të veçantë, përveç negociatave që kemi bërë me Ministrinë e Financave edhe në Komisionin Parlamentar të Ligjeve, edhe Kryetarja e ka nënvijëzuar aty nevojën për mirëmbajtjen e sistemit ICMIS dhe nevojën e këtij fondi, të cilin ne nuk e kemi pasur dhe është një shtesë e re që na vjen, kërkesë e re. Aty në fakt na u premtua që: - Po, këto fonde do kaloheshin. Dhe me thënë të drejtën ato nuk janë, nuk na kanë ardhur si fonde shtesë.

Tani, për çfarë kemi detajuar ne, unë dua t'ju sqaroj që ne këtë fond nuk është se nuk e kemi marrë në konsideratë tani që kemi bërë detajimin e fondeve, ne e kemi marrë. Por sigurisht, kjo do të vijë në një shtrëngim të buxheteve që gjykatat do të kenë përgjatë vitit, për kryerjen e shërbimeve të tjera të cilat duhet t'i mbajnë më të kontrolluara. Fondin për shërbimin e sistemit ICMIS e kemi mbajtur këtu të pashpërndarë dhe kemi mbajtur 25 milion lekë ashtu sikurse kanë qenë bazë referencë për ta përlllogaritur këtë për ne, të paktën që kemi punuar me buxhetin, kanë qenë kontratat ekzistuese me Ministrinë e Drejtësisë. Pastaj, se çfarë do dali më tutje, referuar punës që ju po bëni si Komision dhe unë e sigurt që kjo do të jetë më e madhe, do të jemi këtu, do të flasim, do të shikojmë çfarë mundësish do të kemi për plotësimin.

Naureda Llagami: Me pak fjalë, atë fond që kishte ministria për këtë gjë dhe që ne ia kërkuam edhe në seancën dëgjimore në Komisionin e Ligjeve, ato na premtuan që do na e kalonin automatikisht. Problemi qëndron që në zbardhjen e buxhetit, ndoshta

edhe për shkak të tërmetit, sepse kanë bërë prerje të buxhetit jo vetëm institucionit tonë, por i paskan bërë që të gjithëve, fondin që ato na e prematuan, që e mbajtën shënim dhe e kemi në procesverbal, që do na e kalonin, nuk na e kanë kaluar. Që do të thotë që ne jemi prapë në situatën siç ishim përpara, siç kemi qenë gjatë këtij viti, që në fakt nuk ishte situatë pozitive sepse shumë gjykata kanë pas probleme, nuk kanë ditur që ta menaxhojnë, pavarësisht se ministria e kishte fondin, por për shkak se nuk e kishte pjesën ligjore, që ta administronte këtë gjë, nuk e bënte. Fondi, le të themi, ngeli i paprekur.

Ne kërkuam që ta merrnim me idenë që ne të fillonim të rregullonim pikërisht atë pjesë që ne e kemi diskutuar edhe bashkë Erjon, për komplet sistemin, ato nuk na e kanë dhënë. Nga një komunikim që kam pasur me pjesën e buxhetit, është thënë që ndoshta-ndoshta do kemi një lloj çlirimi buxheti muajt në vijim. Pra nga marsi ne mund të bëjmë një kërkesë të re buxhetore për ndryshimin e buxhetit, për të na e dhënë, duke menduar se qeveria ka pas prioritet kostot e tërmetit në këto muajt e parë dhe më kanë dhënë një lloj shprese, që ndoshta do kemi një rishikim të buxhetit tonë, duke filluar nga marsi. Le të shpresojmë. Dhe ne ndërkohë, deri në mars do jemi shumë të kujdesshëm në pjesën e menaxhimit të buxhetit.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Desha, në vijim të kësaj që sapo përmendët tani në fund, desha të sjell në vëmendje edhe faktin që do duhen investime edhe sa i përket riparimit ose ndërtimit të godinave që tashmë i kemi jo funksionale, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë. Kështu që, këto do të kërkojnë fonde shtesë. Faleminderit!

Luljeta Laze: Atëherë, në përgjigje të shqetësimit që ju keni ngritur. Unë ju thashë që në fillim që në këtë moment nuk jemi duke detajuar fondet për investime sepse jemi në pritje edhe të situatës për të vlerësuar 100% realizimet e këtij viti. Ka pasur një bllokim në thesar. Nuk dimë domethënë situatën përfundimtare edhe për të marrë të gjitha vlerësimet në gjykatat për nevojën e fondeve që kanë për rindërtimin e godinave për eliminimin e dëmeve. Kështu që, me ta marrë të gjithë këtë situatë, neve do të bëjmë edhe detajimin e fondeve për investimet.

Edhe ajo që Kryetarja sapo tha, përveçqë duhet të detajojmë nga fondi jonë që nuk është ndonjë fond i investimeve kushedi se çfarë, për t'i plotësuar të gjitha nevojat, do të kërkojmë edhe fondet shtesë duke bërë pikërisht këto referenca, që një pjesë e këtyre ka ardhur jo si pjesë e planeve tona të zhvillimit, por për shkak të dëmeve nga

tërmeti dhe një pjesë të tjera që nuk na janë plotësuar, që i kemi nevoja emergjente.

Naureda Llagami: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Luli, përveç burimeve njerëzore në sistemin e sigurisë së gjykatave, infrastrukturë sigurie është parashikuar në buxhet, për sisteme sigurie? Detektorë.

Luljeta Laze: Në fakt, nuk po e detajojmë fondin e investimeve këtu, që të jemi të qartë, por përtej kësaj ne e kemi të plotë databejzin (database) e gjithë gjykatave si dhe plotësimin me hapa shumë të vegjël që bëjmë për të gjitha gjykatat dhe në momentin që do të detajojmë fondin e investimeve, përsëri do t'i keni të gjithë pasqyrat të qarta.

Le të themi për këtë që ju sapo përmendët. Për detektorët, pothuajse të gjitha gjykatat (mund të jetë ndonjë në veçanti që unë tani nuk e di që e nuk e ka, por e kanë). Por ka edhe elementë të tjerë të sigurisë që gjykatat i kanë të plotësuar, ka edhe elementë që ne mendojmë që nuk i kanë të plotësuar. Kur të detajojmë fondin e investimeve, neve do t'ju japim tabelat të qarta për secilën gjykatë, se në çfarë shtate është dhe çfarë mendohet. Do ndajmë edhe prioritetet aty, për shembull kemi edhe këtë krijimin e ambienteve... janë edhe projekte të vogla që bëjnë plotësim objektivash. Për shembull, sivjet do jemi të detyruar ta shikojmë pak edhe atë krijimin e ambienteve miqësore për të mitur. Është pjesë e planit tonë strategjik. Është pjesë e kërkesave nga institucionet ndërkombëtare me të cilat... detyrim ligjor, që kanë dalë me kodet e reja dhe këto për shembull ndërthuren/futen midis, pra ke disa projekte që ti je në vijimësi, siç është kjo e plotësimin të sigurisë së gjykatave, që ti po thua që (sipas planit tënd) kam bërë kaq, do vazhdoj vitin tjetër kaq, por ndërkohë krijohen edhe disa situata të tjera, je detyruar të përfshish për shembull këto apo për personat me aftësi të kufizuar, krijimin e mundësisë së aksesit për ata.

Megjithatë, ju sapo thoni për sigurinë e gjykatave që përmendët, do keni tabela të qarta, që të tregojë, për secilën nga gjykatat, se si e ka situatën.

Në qoftë se ke ndonjë merak konkret, mund ta mbaj shënim dhe ta shikoj.

Jo, se edhe nga njohja e situatës... Kjo është.

Alban Toro: Pavarësisht se në përgjithësi gjykatat janë për faqe të zezë nga siguria, pyetja e dytë është në lidhje me një problem që do kemi së shpejti për të caktuar gjyqtarë në gjykatat e zakonshme tek gjykata e posaçme për çështje të caktuara. Natyrisht ato do duhet të privohen nga jeta private, pra të nënshkruajnë një deklaratë ku i nënshtrohen mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe për ta kompensuar këtë do na duhet që, pra

për ta bërë sa më atraktiv që këta gjyqtarë të japin vullnetin për t'iu nënshtuar këtij rrëgjimi, do të na duhet të krijojmë edhe një fond të veçantë, ndoshta për t'i kompensuar këtë privim, në raport me pagën që kanë. Është parashikuar një skemë, a një fond i veçantë për këtë pjesë.

Luljeta Laze: Më fal!

Në ç'kuptim?

Do emërohen aty, tek gjykata e posaçme?

Ilir Toska: Atëherë, problemi që ngriti zoti Toro është një çështje që i përket të ardhmes dhe ne ende nuk kemi vendosur se çfarë do bëjmë.

Në fakt, meqenëse jemi duke miratuar buxhetin që përfshihet edhe fondi i pagave, do desha të dija se si është përlllogaritur paga e gjyqtarit të gjykatave të posaçme dhe personeli. Çfarë ka konsideruar buxheti këtë herë për ata.

Luljeta Laze: Për gjykatat e posaçme ne kemi konsideruar fondin e pagave për ta, e cila deri në këtë moment është e përcaktuar që ka një nivel më të lartë, për shembull gjykata e apelit e ka sa Gjykata e Lartë dhe gjykata e shkallës së parë e ka sa gjykata e apelit. Akte të tjera nuk kemi dhe neve nuk mund të kemi parashikuar. Megjithatë, unë sapo ju shpjegova që neve kemi fond rezervë, tek fondi i pagave, për 100 punonjësit shtesë, për 71 që do i marrim me kontratë, për magjistratët kur të emërohen dhe ky është një fond që mund të përdoret, për shembull, për punonjësit shtesë ne kemi llogaritur për 12 muaj. Është e pamundur që në datën 1 janar ju të keni bërë gati edhe detajimin për ku do shkojnë të gjithë. Pra, për arsye objektive, në zhvillimin e aktiviteteve, krijohen fonde të tjera të cilat mund të menaxhohen bazuar tek kërkesa të tjera ligjore që dalin, sikurse është kjo.

Nuk është e qartë akoma se sa do e marrin... se nuk ka dalë akoma edhe vendimi i qeverisë se çfarë shtese do kenë ata. Dhe ka dy mënyra: e para, kur do dali, mund të kërkojmë diçka shtesë dhe...

Ilir Toska: Të ndërhyj tek ky moment.

Ju i referoheni, edhe në një takim informal që keni pasur, thoni që për gjykatat e posaçme duhet të dali një vendim qeverie për të marrë një shpërblim shtesë. Në fakt, tek dispozita e ligjit të Statusit nuk ka ndonjë përcaktim që lidh tek struktura e pagës ndonjë vendim të Këshillit të Ministrave. Në fakt, tek ligji për institucionet e posaçme nuk ka ndonjë përcaktim konkret për pagën, por tek shtojcat e tyre ka një përcaktim "që merr një

pagë plus”.

Maksim Qoku: Kë shumë të drejtë, por është problemi joni ai problem. Pse ia thua Lulit?

Ilir Toska: Lulit ia them se Luli ka bërë llogaritë për pagat, prandaj po pyes Lulin çfarë llogarish ka bërë.

Tani, në qoftë se s’ të pëlqen ty zoti Qoku, mund të ndërhyri dhe të vazhdoni të thoni... Unë dua të di se çfarë ka bërë. Që të kuptoj. Si është llogaritur, po pyes.

Luljeta Laze: Atëherë, unë do t’ju thoja që fondet janë llogaritur çfarë ju shpjegova deri tani dhe me të patur një akt tjetër ne do të shikojmë si të menaxhojmë fondet që unë thashë që i kemi të pashpërndara. Por nuk jemi të qartë në atë përcaktimin se sa do të jetë shtesa. Me thënë të drejtën është shumë e paqartë për ne, ajo që thoni edhe juve. Një pagë shtesë, por në sa kohë është kjo paga shtesë. Domethënë, kur bëhet fjalë për akte të pagesës ne do të kërkonim sqarime pastaj të mëtejshme.

Ilir Toska: (Pa mikrofon) Pra ju nuk e keni konsideruar shtesë më vete.

Luljeta Laze: Jo! Nuk e kemi konsideruar.

Unë, kur e kam lexuar atë, ashtu siç e kam kuptuar, si operojmë ne me fondet e pagave, e kam kuptuar si një pagë të 13, si një pagë shtesë dhe për çfarë kam diskutuar ose fjalë që më kanë ardhur nga gjykata, konsiderojnë një pagë për çdo muaj. Gjë që mua më duket absurde. Kështu që kur të ketë një përcaktim të qartë për këtë, përveç fondeve që ne kemi, sigurisht kur bëhet fjalë për një akt, mund të kërkojmë edhe fonde shtesë duke bërë shpjegimet përkatëse.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër para se ta kalojmë në votim?

Atëherë, kalojmë në votim detajimin e fondeve buxhetore dhe shpenzimeve korente për sistemin gjyqësor, sipas pasqyrave që u prezantuan.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të miratojë detajimin e fondeve buxhetore, shpenzimeve korente (ku përfshihen shpenzimet për paga, shpenzimet sigurimeve shoqërore dhe shpenzime operative) për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2020, sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij vendimi.

Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Atëherë, në qoftë se nuk kemi ndonjë gjë tjetër për të diskutuar, besoj se kjo është mbledhja e fundit për vitin 2019.

Përfitoj nga rasti t'ju them Gëzuar Vitin e Ri, Gëzuar Festat. Takohemi në 2020-ën.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor